

Seancës Plenare
15/12/2022

KUVENDI
NR 4220 DATE 15.12.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. Prot. Tiranë, më __/__/2022

Lënda: Nismë ligjore për amendimin e ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës Bujqësore", të ndryshuar"

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

E nderuar Kryetare,

Bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës dhe nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projektligjin "Për disa shtesa në Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar.

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues.

Lutem marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,

Erion BRAÇE

DEPUTET



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. _____ 2022

**"PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 9244, DATË 17.6.2004, "PËR MBROJTJEN E
TOKËS BUJQËSORE", TË NDRYSHUAR"**

Në ligjin nr. 9244 datë 17.06.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 14, shtohet një nen 14/a me këtë përmbajtje:

- “1. Ndalohet ndezja e zjarreve në tokat bujqësore, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 deri 6 të këtij neni.
2. Ndalohet djegia e lendës kashtë apo mbetjeve të tjera bujqësore, barërave, ferrave apo shkurreve, që rrezikojnë përhapjen e zjarreve në toka bujqësore, pyje dhe kullota, gjatë periudhës nga 1 Prilli deri 30 Nëntor të çdo viti.
3. Për periudhën tjetër të vitit ky proces mund të kryhet vetëm pas:
 - a. marrjes së lejes nga njësia e qeverisjes vendore, ku specifikohen: emri i personit apo personave që marrin përsipër veprimin e djegies; vendndodhja e sipërfaqes që do të digjet, datën dhe orën kur do bëhet djegia; pëlqimi me shkrim i pronarëve ose poseduesve të pronave në kufi me pronën ku do të kryhet djegia;

b. marrjes së lejes nga shërbimet e mbrojtjes civile, ku përshkruhen masat parandaluese që zjarri të mos dalë jashtë kontrollit, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

4. Djegia e tokave bujqësore, vreshtave, pemtoreve, shkurreve e ferrave, referuar pikës 3 të këtij neni, në çdo rast duhet të bëhet duke plotësuar kushtet e mëposhtme :

- nisë dhe të përfundojë gjatë orëve të ditës (nga ora 08:00 - 18.00);

5. Në çdo rast ndalohet ndezja e zjarreve:

a) në zona që shtrihen brenda territorit të zonave të mbrojtura, zonave turistike, pikave të kalimit kufitar apo zonave kufitare të Republikës së Shqipërisë;

b) në distancë më të afërt se 100 metra nga akset rrugore kombëtare;

c) në distancë më të afërt se 2000 metra nga sipërfaqet pyjore, plantacionet me drurë të ndryshëm dhe vreshtat;

ç) në distancë më të afërt se 1000 metra nga pikat e shitjes së karburanteve apo depozitat e tyre;

d) në distancë më të afërt se 2000 metra nga fshati më i afërt dhe së paku 2000 metra larg çdo banese individuale;

dh) në ditët kur era fryn me shpejtësi mbi 20 km/orë, edhe nëse janë marrë lejet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;

e) në një sipërfaqe më të madhe se 1000 m² brenda një dite.

6. Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, në raste përjashtimore lejohet djegia në tokat bujqësore kur shfaqet domosdoshmëria e mbajtjes nën kontroll të sëmundjeve ose faktorëve të tjerë dëmtues, bazuar në urdhërin e posaçëm të autoritetit kompetent për marrjen e masave emergjente kundër fatkeqësive natyrore.

7. Rregulla të hollësishëm për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 2

Në nenin 28, pas pikës d) shtohet një pikë dh) me këtë përmbajtje:

“dh) moszbatimi, nga pronaret e tokës bujqësore dhe posedues të tjerë të ligjshëm, të kërkesave të nenit 14/a të këtij ligji, në rastet kur veprimtaria nuk përbën veprën penale të shkatërrimit të tokës, sipas përcaktimeve të nenit 23 të këtij ligj

Neni 3

Dispozitë kalimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve të nxjerrë aktin nënligjor të përcaktuar në pikën 7 të nenit 1 të këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA